V E N D I M
Nr.169, datë 22.3.1993

PËR ARBITRIMIN NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE PARA LIDHJES SË KONTRATËS KOLEKTIVE TË PUNËS

Në zbatim të ligjit nr.7673, datë 17.2.1993 "Për kontratat kolektive të punës", me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I

1. Kur ndërmjetësimi nuk është i sukseshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve para lidhjes së kontratës kolektive, palët mund të zgjedhin një arbitër nga lista e arbitrave të miratuar nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

2. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë përcakton procedurat për zgjedhjen e arbitrave dhe testimin e njohurive të tyre profesionale.

Lista e arbitrave miratohet nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

3. Arbitër mund të jetë çdo person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mundësisht jurist, me kusht që të pranojë vullnetarisht detyrën e arbitrit.

4. Për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje arbitër dhe ndërmjetës nuk mund të jetë i njëjti person.

5. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes palët mund t'i drejtohen bashkërisht me shkrim një arbitri. Procedura e arbitrimit fillon që nga data kur arbitri pranon kërkesën e palëve.

6. Kur palët nuk bien dakord për zgjedhjen e një arbitri, ky përcaktohet nga ministri i Punës, Emgracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, mbi bazën e kërkesës që palët i paraqesin atij. Procedura e arbitrimit fillon që nga data e caktimit të arbitrit.

7. Arbitri u njofton palëve me shkrim vendimin e tij brenda 30 ditëve nga data e fillimit të procedurës së arbitrimit. Kur palët janë dakord me vendimin e dhënë, kontrata quhet e përfunduar që nga data kur arbitri u komunikon atyre vendimin.

8. Shpenzimet e arbitrimit përballohen nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

9. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, përcakton kufijtë e pagesës së arbitrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit nr.7673, datë 17.2.1993 "Për kontratat kolektive të punës".

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi